



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:235661  
Datë: 26.03.2024  
Numri i dokumentit: 05504031

Ac.nr.7583/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj, kryetar i kolegjit, Ardian Ajvazi dhe Halide Reka, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit NLB Prishtina sh.a, me seli në Prishtinë, rr. “Kosta Novaković”, në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Zyrtarja e Lartë për Punë Juridike pranë kësaj banke Eneida Lajqi, kundër të paditurit L. I nga Prishtina, rr. “Bregu i Diellit”, Mati 1, ne Prishtinë, me objekt të padisë kompensim dëmi, duke vendosur sipas ankesave të paditësit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.532/15, të datës 22.05.2023 dhe aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.532/15, të datës 16.06.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 22.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat e paditësit NLB Prishtina sh.a, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.532/15, të datës 22.05.2023 dhe aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.532/15, të datës 16.06.2023, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar C.nr.532/15, të datës 22.05.2023, ka vendosur si në vijim: KONSIDEROHET SE ËSHTË TËRHEQUR padia e paditësit NLB Prishtina sh. a, me seli në Prishtinë, kundër të paditurit L. I nga Prishtina, në këtë çështje juridike kontestimore për kompensimin e dëmit. Ndërsa me aktvendimin e ankimuar C.nr.532/15, të datës 16.06.2023 ka vendosur si në vijim: HEDHET POSHTË si i pasafatshëm Propozimi i dt. 13.06.2023 i propozuesit NLB Prishtina sh.a, me seli në Prishtinë, në këtë çështje juridike kontestimore për shkak të lëshimit të pjesëmarrjes në seancën përgatitore të dt.22.05.2023, sipas padisë për kompensim dëmi.

Kundër këtyre aktvendimeve, paditësi përmes të autorizuarit të tij, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa e palës paditëse të aprovohet ndërsa aktvendimet e ankimura të anulohen.

Nga shkresat e lëndës nuk mund të gjendet se i padituri të ketë parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesat e paditësit janë të pabazuara.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, me datë 05.03.2015, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurit, për kompensim dëmi, me pretendimet se i padituri ka shpërdoruar autorizimet dhe me një rast ka siguruar Ofertën një qytetari që nuk ka qenë klient i bankës duke rrezikuar pasurinë e bankës dhe duke i shkaktuar dëm në vlerë prej 10,405.80 €, andaj përmes padisë ka kërkuar që të detyrohet i padituri që këtë shumë t'ia paguajë paditësit së bashku me kamatën 8 % duke llogaritur nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin C.nr.532/15, të datës 22.05.2023 e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditësit në këtë çështje kontestimore duke e arsyetuar në kuptim të nenit 409.1 të LPK-së, me theksimet se në seancën e datës 22.05.2023 në procesverbal është konstatuar mungesa e palës paditëse e cila nuk e ka arsyetuar mungesën dhe nuk ka kërkuar shtyrjen e seancës, derisa me aktvendimin C.nr.532/15, të datës 16.06.2023 e ka hedhur poshtë si të pasafatshëm propozimin e paditësit.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktvendimet e atakuara nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkelje Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që me dispozitën e nenit 409 paragrafi 1 të LPK-së shprehimisht parashihet se “ *Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet*”. Në rastin konkret fakti se pala paditëse, përkatësisht i autorizuari i tij ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën nuk e ka arsyetuar për pjesëmarrje në seancën e datës 22.05.2023, konstatohet nga procesverbali i seancës së datës 04.04.2023, në të cilën ka qenë prezent e autorizuar e paditësit dhe e njëjta është njoftuar gjatë seancës për shtyrjen e seancës për datë 22.05.2023, në ora 13:00, e i cili njoftim i ka shërbyer në vend të ftesës së rregullt. Andaj, gjykatës së shkallës së dytë i rezultoi se paditësi ka qenë i njoftuar për ditën e mbajtjes së seancës ndërsa nuk ka prezantuar në seancë dhe mungesën nuk e ka arsyetuar, prandaj përfundimi i gjykatës për tërheqjen e padisë është i drejtë dhe i ligjshëm konform edhe dispozitës ligjore të lartë cekur.

Meqenëse paditësi e ka shfrytëzuar të drejtën e tij për të paraqitur propozim për kthim në gjendje të mëparshme, gjykata e shkallës së parë të njëjtën e ka shqyrtuar dhe me anë të aktvendimit C.nr.532/15, të datës 16.06.2023, këtë propozim e ka hedhur poshtë si të pasafatshëm konform nenit 131, paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës paditëse se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si pasojë e së cilës edhe ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale, pasi që referuar dispozitave ligjore të sipërcituara si dhe shkresave të lëndës, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka konstatuar faktin se përfaqësuesja e paditësit propozimin për kthim në gjendje të mëparshme e ka dorëzuar në gjykatë me datë 13.06.2023, pas afatit të paraparë ligjor, pasi që e njëjta ndonëse ka qenë e ftuar me ftesë të rregullt ashtu siç u shtjellua më lartë me datë 22.05.2023 dhe krahas propozimit ka paraqitur raport mjekësor të datës 22.05.2023, propozimin për kthim në gjendje të mëparshme e ka paraqitur pas kalimit të afatit prej 7 ditëve duke lëshuar kështu afatin e paraparë ligjor për paraqitjen e propozimit për përsëritjen e procedurës. Andaj në rastin konkret drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore nga neni 130, paragrafi 2 të LPK-së, në të cilën parashihet se “130.2 Propozimi duhet të paraqitet brenda afatit shtatë (7) ditor nga dita kur ka pushuar shkaku i mosveprimit, e po që se pala më vonë ka mësuar për mosveprimin, atëherë afati llogaritet nga dita kur ka mësuar për mosveprimin. Si rrjedhojë, shkaqet e paraqitura në ankesat e paditësit, nuk përbëjnë bazë për anulimin e aktvendimeve të atakuara, sepse gjykata e shkallës së parë ka zbatuar me saktësi dispozitat ligjore për pasojën e mungesës së paditëses, përkatësisht të autorizuarit të tij në seancën e datës 22.05.2023 si dhe për hedhjen poshtë të kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) e LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.7583/2023, më datë 22.03.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,  
Besnik Bislimaj